

V E N D I M

“NË EMËR TË REPUBLIKËS”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE : REZARTA BALLIU (VIGANI)

Me pjesëmarrjen e prokurorit Ndini Tavani, asistuar prej sekretares gjyqësore Loreta Merepeza, sot datë 30.07.2015 mori në shqyrtim , kërkesën penale me:

KERKUESE: **F. K.** , e bija e L. dhe M...., datl.19..., lindur në Gurëz-Kurbin dhe banuese në Tiranë, Bulevardi “.....”, K....., Ap.46, përfaqësuar në gjykim me prokurën e posaçme Nr.1912 Rep e Nr.665 Kol, datë 27.07.2015 nga Av.Illir Murati, me Nr.1216 Liçense dhe me NIPT : K 61912001 V .

OBJEKTI: Heqje e masës së sekuestros preventive të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin Nr..... Akti datë 18.04.2015 .

BAZA LIGJORE: Neni 274 dhe 470 e vijues të K.Pr.Penale.

1. *Gjykata pasi shqyrtoi kërkesën e av. të kërkueses , i cili kërkoj pranimin e kërkesës, prokurorin i cili kërkoj pranimin e kërkesës dhe pasi e bisedoi dhe shqyrtoi çështjen në tërësinë e saj,*

V Ë R E N

Se Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë, mbi bazën e materialeve të ardhura nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë, ka regjistruar procedimin penal me Nr..... të vitit 2015, për veprën penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal .

Nga hetimet paraprahe ka rezultuar se, për shtetasit L. R. K. **Alias** N. P. dhe F. L. K. , ka dyshime të bazuara në lidhje me shumata të mëdha të investuara në pasuri, si dhe origjinën e këtyre shumave .

Nga të dhënat për shtetasen F. K. rezulton se, nuk ka biznes të regjistruar, por ka transaksione të vlerave të mëdha në bankën “Credins” sh.a.

Nga informacionet dhe të dhënat e grumbulluara ka rezultuar se shtetësja F. K., ka disa llogari bankare në monedhat Euro dhe USD, në të cilat ka kryer një numër të konsiderueshëm veprimesh me natyrë: derdhje, tërheqje, pagesa me kartë, ka vendosur disa depozita, derdhje nga të tretët, disa prej të cilave janë si më poshtë:

- A) Më datë 30.06.2004 ka derdhur shumën 50 500 Euro.
- B) Më datë 06.07.2005 ka vendosur në depozitë shumën 40 000 Euro.
- C) Më datë 09.12.2005 ka derdhur shumën 25 000 Euro.
- D) Më datë 27.08.2010 ka tërhequr nga llogaria shumën 50 000 Euro.
- E) Më datë 06.12.2011 ka derdhur shumën 20 000 Euro si të ardhura nga shitja e pasurisë.
- F) Më datë 18.04.2014 një urdhër xhirim i brendshëm nga shtetasi E. C. në vlerë 150 000 Euro, kalimi sipas kontratës Nr.
- G) Më datë 28.04.2014 ka vendosur në depozitë me afat 6 mujor shumën 150 031.97 Euro.

Më datë 09.07.2009 sipas kontratës Nr..... Rep e Nr. Kol, ka marrë hua nga banka “Credins” sh.a., shumën 14 000 Euro për shlyerje detyrimi me afat deri në datë 11.09.2009 dhe e siguron bankën nëpërmjet një kontrate për marrëveshje siguroese.

Po në datë 09.07.2009 është lidhur një kontratë e marrëveshjes siguroese Nr. Rep e Nr. Kol, ku si palë barrëdhënëse është shtetasja F. K. dhe palë barrëmarrëse është banka “Credins” sh.a. Objekti i kësaj kontrate është depozita Nr..... me maturim 6 mujor, në vlerë 94 154.52 Euro me normë interesi 4.8%, e cila shërben si garanci për kredinë e marrë në bankë në vlerën 14 000 Euro.

Me kontratën e huadhënies Nr. Rep e Nr..... Kol, datë 15.03.2012 shtetësja F. K. i ka dhënë hua së bashku me shtetasin L. K., shumën 200 000 Euro, për 10 muaj, jashtë zyrës noteriale shtetasve E. e D. C., me një interes 5000 Euro/muaj , e cila do të derdhet çdo datë 15 të muajit pasardhës, në llogari të shtetases F. K..

Në llogarinë e shtetases F. K. rezultojnë derdhjet e kryera nga shtetasi E. C. në datat 13.04.2012; 15.05.2012; 02.07.2012; 16.07.2012 , në vlerë 5 000 Euro në secilën date.

Në “Bankën Kombëtare Tregtare” sh.a.,shtetësja F. K. ka kryer disa transaksione të vlerave monetare . Ajo ka një llogari rrjedhëse dhe një depozitë në monedhën Euro, në të cilën ka kryer veprimet e mëposhtme :

- H) Më datë 18.11.2010 ka derdhur në depozitë me afat 1 vit, shumën 15000 Euro.
- D) Më datë 28.01.2011 ka derdhur në depozitë shumën 5 000 Euro.
- J) Më datë 07.10.2011 ka derdhur shumën 15000 Euro të cilën e ka bashkuar me dy depozitat e mëparshme dhe ka vendosur në depozitë me afat, në total shumën 35 039 Euro.
- K) Më datë 13.03.2012 ka tërhequr depozitën me gjithë interes në vlerë 35 180 Euro;
- L) Më datë 28.06.2013 ka derdhur në depozitë me afat 1 vit shumën 20000 Euro.

Referuar informacioneve të sjella nga organi i akuzës rezulton se, janë vendosur dy “Urdhëra Bllokimi”, të përkohshëm për të gjitha transaksionet dhe veprimet financiare të llogarive në emër të shtetases F. L. K., pranë “Bankës Kombëtare Tregtare”sh.a. dhe bllokimi i përkohshëm, për të gjitha transaksionet dhe veprimet financiare të llogarive në emër të shtetasve F. K., L. K., E. K., A. K., për depozitat pranë “Bankës Credins”sh.a.

Sa sipër, organi i akuzës në mbështetje të nenin 274/2 të Kodit të Proçedures Penale dhe nenit 36 të Kodit Penal , e ka vlerësuar si të nevojshme vendosjen e sekuestros preventive mbi llogaritë e përshkruara me lart duke qenë se disponimi i lirë i tyre mund të rëndojë dhe zgjasë pasojat e veprës penale për të cilën është regjistruar ky proçedim penal, duke sjellë tjetërsimin ose transferimin e tyre tek persona të tretë .

Për këtë arsye, gjykata me kërkesë të organit të akuzës dhe bazuar në nenin 274/2 të Kodit të Proçedurës Penale, në datë 18.04.2015, me vendimin Nr..... Akti, ka vendosur:

- *Pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si të bazuar në ligj dhe në prova .*
- *Vendosjen e sekuestros preventive të llogarive bankare në emër të shtetasve F. K., L. K., E. K. dhe A. K. të depozituara pranë bankës “Credins” sh.a dhe konkretisht të shumës 9.881 USD,të ndodhur në llogarinë bankare Nr..... .*
- *Vendosjen e sekuestros preventive të llogarive bankare të depozituara pranë “Bankës Kombëtare Tregtare” sh.a dhe konkretisht të shumës 150.000 Euro të ndodhuar në llogarinë bankare Nr..... .*

Pasi ky vendim është ekzekutuar, kërkesja me kërkesën drejtuar gjykatës kërkoi heqjen e kësaj sekuestroje preventive të dhënë nga gjykata, për shkak se hetimet e kryera për këtë veprë penale kanë konstatuar se paratë e sekuestruara nuk janë produkt i veprës penale , apo të ardhura nga ndonjë aktivitet kriminal.

Gjykata, pasi e shqyrtoi këtë kërkesë çmon se ajo është e bazuar në prova dhe në ligj, si e tillë duhet të pranohet.

Sipas organit të akuzës, që nga momenti i dhënies së vendimit nga gjykata, janë kryer hetime në lidhje me këtë veprë penale për të cilën është vendosur sekuestroja.Kështu:

- I. Nga procesverbali i ekzekutimit të vendimit të gjykatës për vendosjen e masës së sekuestros datë 20.04.2015 rezulton se, janë bllokuar llogaritë bankare sipas vendimit të gjykatës , llogari këto që kanë qënë vetëm në emër të kërkueses F. K., ndërkohë që për shtetasit e tjerë për të cilët është urdhëruar vendosja e masës nuk kanë rezultuar depozita bankare. Po kështu, rezulton se janë bllokuar llogaritë bankare të kërkueses, llogari këto që ndodhen vetëm në bankën “Credins” sh.a.
- II. Në kuadër të hetimeve për këtë çështje, organi i akuzës , i ka kërkuar ndihmë juridike autoriteteve gjyqësore të Italisë dhe të Spanjës, për të provuar ligjshmërinë e të ardhurave të shtetasit L. K., si dhe të dhëna në lidhje me këtë shtetas, nëse ka ndonjë aktivitet të mundshëm kriminal, procedime ose dënime për këtë shtetas në këto shtete.
- III. Mbas kryerjes së veprimeve hetimore, në lidhje me këtë çështje penale, organi i akuzës në datë 10.07.2015 ka vendosur,

pezullimin e hetimeve të proçedimit penal Nr....., të vitit 2015, për shkak se nuk është bërë e mundur zbulimi i autorit të veprës penale të “Pastrimit të produkteve të veprës penale ose i veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal .

Në nenin 274/3 të K.Pr.Penale është parashikuar:”Kur ndryshojnë kushtet e zbatimit, gjykata me kërkesën e prokurorit ose të të interesuarit, e heq sekuestron”.

Përsa mësipër , gjykata në përfundim të shqyrtimit të kërkesës të kërkueses , pasi analizoi të gjitha provat e paraqitura nga organi i akuzës çmon se, ajo duhet të pranohet si e bazuar në ligj dhe në prova.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata në bazë të nenit 274 të K.Pr.Penale,

V E N D O S I

- I. Pranimin e kërkesës .
- II. Heqjen e masës të sekuestrës preventive dhënë me vendimin Nr..... Akti datë 18.04.2015 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë , të llogarive bankare në emër të shtetasve F. K., L. K., E. K. dhe A. K. të depozituara pranë bankës “Credins” sh.a dhe konkretisht të shumës 9.881 USD,të ndodhur në llogarinë bankare Nr..... .
- III. Heqjen e sekuestrës preventive të llogarive bankare të depozituara pranë “Bankës Kombëtare Tregtare” sh.a dhe konkretisht të shumës 150.000 Euro të ndodhuar në llogarinë bankare Nr..... .
- IV. Kundër këtij vendimi lejohet ankim brenda 10 ditëve në Gjykatën e Apelit ose rekurs i drejtpërdrejtë në Gjykatën e Lartë .
- V. U shpall sot me datë 30.07.2015 Tiranë.

SEKRETARE

GJYQTARE

Loreta MEREPEZA

Rezarta

BALLIU (VIGANI)

